

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES

KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)

MBLEDHJA XXXIV

“Për Konkurrueshmërinë dhe Rritjen e Aksesit në Tregje të Produkteve Shqiptare me Standarde Evropiane”

Tiranë, 3 shtator 2024, 11:30 – 13:00

Mbledhja u drejtua nga Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, z. Blendi Gonxhja, Kryetar i KI. Në mbledhje morën pjesë 18 anëtarë të KI dhe 30 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj dhe institucioneve shtetërore në Shqipëri.

I. Hapja e Mbledhjes nga Ministri Blendi Gonxhja, Kryetar i KI

Në fjalën e tij hyrëse, Ministri Gonxhja theksoi rëndësinë e bashkëpunimit midis qeverisë dhe sektorit privat për të rritur konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare në tregjet evropiane. Më tej, Ministri Gonxhja nënvizoi rëndësinë e përafrimit me standardet evropiane si një kusht i domosdoshëm për integrimin e suksesshëm në BE. Ai thekson nevojën për përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e ekspertizës dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit midis sektorit publik dhe atij privat. Qeveria është e angazhuar për të ndihmuar bizneset në përmbushjen e këtyre standardeve, dhe po punohet për krijimin e një portali unik për eksportuesit. Në përfundim, z. Gonxhja ftoi pjesëmarrësit të kontribuojnë me ide për të adresuar çështjet urgjente dhe për të bashkëpunuar për arritjen e objektivave të përbashkëta, duke shprehur mirënjohje për organizatorët dhe mbështetësit e Këshillit të Investimeve, BERZH dhe SECO.

II. Prezantimi i Sekretariatit të Këshillit të Investimeve

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, prezantoi gjetjet kryesore të analizës së tij, e cila bazohej në shqyrtimin e raporteve më të fundit, konsultimet me aktorë kryesorë nga sektori publik dhe privat (përmes fokus grupeve), si dhe një pyetësori të plotësuar nga 143 biznese. Sfidat kryesore përfshinin mungesë në të dhënat institucionale (për produktet jo-ushqimore) për operatorët ekonomikë vendas me përparësi konkurruese dhe potencialë për eksport, ndërgjegjësimin e ulët të biznesit mbi kuadrin ligjor dhe rregullator që përcakton të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me përgjegjësitë brenda zinxhirit të furnizimit për vendosjen e produkteve të tyre në treg, mungesën e mbështetjes institucionale në drejtim të informimit apo kostove të harmonizimit të kërkesave për produkte cilësore, ekspertizën dhe njohuritë e limituara mbi standardet, etj. Rekomandimet e propozuara përfshinin përgatitjen e një liste prioritare të produkteve vendase (jo ushqimore) me potencial eksporti dhe hartimin e politikave mbështetëse përkatëse, lehtësimin e aksesit në informacion përmes inovacionit të kanaleve të komunikimit zyrtar, përsheptimin e përafrimit ligjor/rregullator në fushën e ndërtimit, përmirësimin e mirëfunksionimit të mbikëqyrjes së tregut dhe rritjen e dijeve dhe ndërgjegjësimin për standardet dhe praktikatat më të mira.

III. Përmbledhje e diskutimeve kryesore

Z. Ardian Lekaj, Dhoma e Biznesit të Diasporës, trajtoi disa çështje të rëndësishme në lidhje me ekonominë shqiptare dhe potencialin për eksportim të produkteve dhe shërbimeve. Ai

përmend nevojën për një analizë të detajuar dhe një bazë të dhënash të produkteve shqiptare që mund të kenë interes në tregjet ndërkombëtare, si dhe rëndësinë e certifikimeve ndërkombëtare, si Global GAP, për të ndihmuar prodhuesit shqiptarë të dalin në tregjet ndërkombëtare. Z. Lekaj theksoi gjithashtu se Shqipëria duhet të fokusohet në sektorë ku ka avantazh, si bujqësia, industria e ndërtimit dhe energjia. Ai përmendi një shembull konkret ku një fermer shqiptar, falë një certifikate dhe mbështetjes së duhur, arriti të kalojë nga falimentimi në një sukses të madh financiar. Në përfundim, ai nënvizoi rëndësinë e edukimit dhe specializimit të fuqisë punëtore, duke argumentuar se Shqipëria duhet të investojë në fusha ku kërkohet teknologji e lartë dhe fuqi punëtore e specializuar, si energjia dhe eksporti i shërbimeve, duke marrë shembull nga vende të tjera si Polonia, Bullgaria dhe Rumania.

Znj. Ines Muçostepa, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, shprehu mirënjohje ndaj ministrit për komunikimin e qartë dhe të drejtpërdrejtë. Gjatë fjalës së saj, znj. Muçostepa nënvizoi përpjekjet e vazhdueshme për të forcuar kapacitetet institucionale dhe bashkëpunimin rajonal, duke theksuar nevojën për dhoma tregtie më të forta. Më tej, ajo i informoi anëtarët mbi disa nisma të fundit rajonale ku është përfshirë dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë. Një prej tyre ishte krijimi i një platforme rajonale për aksesin në treg, e ndarë në katër module kryesore. Kjo platformë ka mundur që 7,500 kompani në rajon të plotësojnë standardet konkurruese. Ajo gjithashtu informoi mbi disa evente të ardhshme në Berlin dhe Itali, të cilat synojnë trajnimin e bizneseve dhe lehtësimin e takimeve B2B në sektorë si infrastruktura, bujqësia, automotiva dhe ndërtimi. Znj. Muçostepa përmendi gjithashtu edhe disa përpjekje për krijimin e platformave për certifikimin CE, i cili është thelbësor për produktet që hyjnë në BE, dhe zhvillimin e një marke kolektive për të promovuar produktet e Ballkanit në BE. Ajo theksoi rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit mes bizneseve për këto mundësi dhe shprehu nevojën për përmirësimin e shpërndarjes së informacionit në mënyrë që bizneset të përfitojnë sa më shumë nga burimet e disponueshme.

Znj. Albana Laknori, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, shprehu vlerësimin për bashkëpunimin aktiv që ekziston brenda KI, i cili vjen edhe në sajë të bashkëpunimit serioz të Sekretariatit. Më tej, znj. Laknori shprehu shqetësimin për mungesën e komunikimit dhe transparencës nga ana e shtetit, sidomos Ministrisë së Ekonomisë, veçanërisht në kuadër të procesit *screening* dhe mbledhjeve të mbajtuara në Bruksel. Ajo vuri në dukje se bizneset nuk janë informuar mbi këto zhvillime dhe nëse komentet e tyre janë marrë parasysh apo jo. Ajo theksoi rëndësinë e mbështetjes financiare për bizneset që eksportojnë dhe nënvizoi se produktet shqiptare ende nuk janë konkurruese, duke e krahasuar këtë situatë me shtetet fqinje si Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Në fund, znj. Laknori bëri thirrje për më shumë përfshirje dhe informim të institucioneve të biznesit, duke theksuar rëndësinë e shpërndarjes së informacionit tek anëtarët e tyre. Ajo tregoi një shembull konkret nga një kompani në Dibrë që përballlet me sfida për eksportin e produkteve dhe përfitimin e certifikatës së origjinës, duke nënvizuar rëndësinë e transparencës dhe informimit për bizneset.

Z. Edvin Prençe, Pro-Eksport Albania, ngriti shqetësimin për konkurrencën e pabarabartë që përballen bizneset shqiptare kundrejt produkteve të importuara, të cilat shpesh mbështeten financiarisht nga vendet e tyre të origjinës. Ai theksoi se, megjithëse sektori i fasonerisë eksporton mbi 40 milionë njësi veshmbathjesh, produktet vendase përballen me vështirësi të mëdha në konkurrimin brenda tregut shqiptar, për shkak të mungesës së incentivimit dhe orientimit nga ana e qeverisë. Një tjetër shqetësim që ai ngriti ishte paradoksi i eksportimit të lëkurës së gjallë (të papërpunuar) nga Shqipëria me vlerë 30 milionë euro, ndërkohë që i njëjti sektor importon lëkura të përpunuara me vlerë 300 milionë euro. Kjo tregon mungesën e madhe të mbështetjes për

përpunimin e lëndës së parë brenda vendit dhe theksoi se sektori i fasonerisë ka nevojë për lëndën e parë, pasi prodhimi vendas nuk është i mjaftueshëm.

Gjithashtu, ai shprehu shqetësim për mungesën e transparencës dhe besueshmërisë në proceset qeveritare, duke vënë në dukje se shumë vendime dhe politika të diskutuara mbeten të pazbatuara. Në lidhje me marrëveshjen CEFTA, ai kritikoi faktin që Shqipëria respekton rregullat e tregtisë rajonale, por nuk përfiton në mënyrë të barabartë nga to. Ai përmendi se taksat për lëndët e para janë të larta në krahasim me përfitimet që ofrohen në vendet evropiane dhe kërkoi që këto lëndë të para të trajtohen me taksa zero për të rritur konkurrueshmërinë e sektorit vendas.

Në fund, ai kërkoi rritjen e nivelit të përmbushjes së rekomandimeve nga takimet e mëparshme të KI dhe shprehu shpresën se ministri do të ndihmojë në përmirësimin dhe mbështetje më të madhe për sektorin.

Znj. Antonela Hako, Dhoma Ekonomike e Gruas, përshëndeti anëtarët dhe përmendi përvojën e saj tridhjetë vjeçare në industrinë e prodhimit ushqimor, ku shprehu shqetësimet e saj për mungesën e vëmendjes dhe mbështetjes nga ana e qeverisë ndaj këtij sektori. Ajo theksoi se, ndonëse industria ushqimore nuk shihet si prioritet, sfidat me të cilat përballen ndërmarrjet brenda këtij sektori janë të ngjashme me ato që hasin edhe sektorët e tjerë, dhe për to kërkohen zgjidhje të menjëhershme. Disa nga shqetësimet kryesore të ngritura:

- Procesi i certifikimit të produkteve. Ajo vuri në dukje se, ndonëse ndërmarrjet shqiptare kanë marrë certifikimet e nevojshme si njësi prodhuese, produktet e tyre ende nuk janë të certifikuara, gjë që paraqet një pengesë të madhe për eksportin dhe konkurrueshmërinë në tregjet ndërkombëtare, veçanërisht në Bashkimin Evropian. Sipas saj, ndërgjegjësimi për rëndësinë e certifikimit të produkteve nuk është vetëm një çështje dëshire nga ana e bizneseve, por kërkon gjithashtu një strategji të mirëfilltë tregu nga qeveria.
- Duhet që qeveria të angazhohet më seriozisht në krijimin e një strategjie tregu që do të ndihmojë ndërmarrjet shqiptare të përmbushin standardet e kërkuara nga Bashkimi Evropian, duke ofruar njëkohësisht mbështetje financiare për investimet e nevojshme. Ajo theksoi se për të arritur këto standarde dhe për të hyrë me sukses në tregjet evropiane, kompanitë shqiptare kanë nevojë për investime shtesë, përveç atyre që kanë bërë deri më tani. Kjo mbështetje është jetike për të siguruar që produktet shqiptare të jenë të pranueshme dhe konkurruese në tregun evropian.

Në përfundim të fjalës së saj, znj. Hako sugjeroi që pas disa muajsh të organizohet një takim i dytë për të shqyrtuar progresin e arritur dhe për të diskutuar masat e mëtejshme që duhen ndërmarrë për përmirësimin e sektorit. Ajo nënvizoi rëndësinë e këtij dialogu të vazhdueshëm midis qeverisë dhe sektorit privat, për të siguruar që shqetësimet e ngritura të mos mbeten vetëm në letër, por të përkthehen në veprime konkrete që mbështesin dhe fuqizojnë industrinë ushqimore shqiptare.

Z. Emanuel Salinas, Banka Botërore, falenderoi ministrin dhe shprehu mbështetje për analizën dhe çështjet e ngritura. Ai ngriti disa çështje dhe rekomandime:

- Investimi në infrastrukturën kombëtare të cilësisë. Ai theksoi nevojën për një infrastrukturë cilësore kombëtare për certifikimin e prodhuesve shqiptarë. Boshllëqet aktuale në institucione, materiale dhe sisteme duhet të adresohen për të përmirësuar procesin e certifikimit të cilësisë.
- Pengesat Burokratike. Eliminimi i barrierave burokratike ndaj eksportit dhe importit është i nevojshëm, duke sugjeruar që ndërkohë që është ecur përpara me Dritaren e Vetme Kombëtare për Doganat, nevojiten ende përmirësime të mëtejshme.
- Mbështetje për futjen e teknologjisë. Ridizenjimi i instrumenteve mbështetës për të ndihmuar adoptimin e teknologjisë dhe përmirësimin e cilësisë, duke vënë në dukje se nevojiten investime

të konsiderueshme dhe për këtë biznesi nuk mund të mbështetet vetëm tek sektori financiar. Qeveria duhet të luajë një rol të rëndësishëm në këtë aspekt.

- Programet e Certifikimit të Cilësisë: Nevojitet zhvillimi i programeve për të ndihmuar kompanitë në marrjen e certifikatave të cilësisë, pasi këto mund të jenë të kushtueshme dhe sfiduese për shumë biznese, edhe nëse ato kanë përmirësuar proceset e tyre të prodhimit.
- Inovacioni dhe proceset e prodhimit: Inovacioni është i rëndësishëm në proceset e prodhimit, jo vetëm për zgjidhje të teknologjisë së lartë, por edhe për përmirësime praktike që mund të rrisin efikasitetin dhe cilësinë e produktit.
- Rishikimi i Programit TiVET: Nevojitet rishikimi i programeve të Arsimit dhe Trajnimit Teknik dhe Profesional (TiVET) për të përfshirë lëndën e cilësisë, si aftësi thelbësore dhe për të nxitur një fuqi punëtore të kualifikuar në këtë fushë.
- Ridizënjimi i Politikës së Investimeve: Nevojitet një ridizënjim i politikave të investimeve për të tërhequr investitorët e huaj që janë të fokusuar në zinxhirët e vlerës globale dhe që do të ndihmonin prodhuesit shqiptarë të lidhen me tregun global (si p.sh. supermarketet e huaja), në vend të atyre që investojnë në hotele dhe restorante moderne që tashmë janë të bollshme në vend.
- Përmirësimet në kalimin kufitar: Është urgjente nevoja për përmirësimin e pikave të kalimit kufitar për të parandaluar vonesat dhe prishjen e produkteve (veçanërisht bujqësore) në doganë, duke përmendur nevojën për përpunim më të shpejtë dhe më efikas.
- Rregulloret dhe inspektimet: Rregulloret dhe inspektimet duhet të ofrojnë siguri për prodhuesit në vend dhe të eliminojnë gabimet dhe pengesat burokratike.

Ai përfundoi duke shprehur gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar me qeverinë për të adresuar këto sfida dhe për të përshpejtuar përmirësimet në këtë fushë.

Znj. Ekaterina Solovova, BERZH, shprehu vlerësimin e saj për përgatitjen e kësaj mbledhje dhe raportin e progresit të KI-së, duke falenderuar Sekretariatin teknik për punën e tij. Ajo u shpreh se diskutimet e ngritura në këtë tryezë janë relevante dhe praktike, ndërsa ngriti disa pika të tjera. Fillimisht, ajo vuri në dukje nevojën për përmirësime të menjëhershme në vend, siç janë ndryshimet e legjislacionit përkatës që do të mundësonin zhbllokimin e eksportit të produkteve specifike, si p.sh. të materialeve të ndërtimit. Gjithashtu, ajo nënvizoi rëndësinë e fokusimit në avantazhet konkurruese të Shqipërisë në tregun global, duke reflektuar mbi sfidat me të cilat përballen eksportuesit shqiptarë, siç janë zhvlerësimi i euros dhe rritja e kostos së punës, duke u shprehur se strategjitë e bazuara në kosto të ulët dhe fuqi punëtore të lirë nuk do të jenë të qëndrueshme në të ardhmen. Ajo theksoi se përmirësimet në infrastrukturë po ecin me ritme të mira dhe i japin Shqipërisë mundësinë për të krijuar qendra tranziti në Ballkanin Perëndimor, ku eksporti i energjisë mund të jetë një mundësi e afërt. Ajo gjithashtu sugjeroi që Shqipëria të bëhet një destinacion tërheqës për kompanitë që bazojnë punën e tyre në njohuri, duke ngritur qendra rajonale në vend dhe tërhequr fuqi punëtore vendase dhe ndërkombëtare. Ndërsa theksoi rëndësinë e eksporteve, ajo gjithashtu nënvizoi nevojën që kompanitë shqiptare të mbeten konkurruese në tregun vendas, duke pasur parasysh konkurrencën nga produktet e BE-së dhe duke kërkuar rritje të ndërgjegjësimit dhe gatishmërisë së NVM-ve shqiptare, veçanërisht atyre që i shërbejnë tregut të brendshëm. Në fund, ajo falënderoi për mundësinë për t'u përfshirë në këtë diskutime dhe nënvizoi rëndësinë e adresimit të këtyre çështjeve.

Z. Hubert Perr, Delegacioni i BE-së, ngriti pesë pikat e mëposhtme:

1. Fushat e fokusit për Shqipërinë: Dy vite më parë, Qeveria Shqiptare prezantoi një strategji kombëtare në të cilën theksohej se Shqipëria, si një vend i vogël, duhet të fokusohet në avantazhet e saj krahasuese, veçanërisht në turizëm, bujqësi, infrastrukturë dixhitale dhe

- energjia. Ai theksoi rëndësinë e harmonizimit të përpjekjeve në këto fusha, si dhe adresimin e çështjeve si rënia e prodhimit bujqësor pavarësisht rritjes së turizmit.
2. Tregu dhe standardet e BE-së: Rregullat e hyrjes në tregun e BE-së janë të komplikuar, siç janë standardet e sigurisë ushqimore, por këto standarde mbrojnë si konsumatorët e BE-së ashtu edhe ata shqiptarë. Për këtë arsye, Shqipëria duhet t'i shohë këto standarde pozitivisht dhe të punojë drejt përmbushjes së tyre.
 3. Negociatat e anëtarësimit në BE: Anëtarësimi në BE përfshin miratimin e standardeve të BE-së, jo vetëm negociimin. Për këtë arsye Shqipëria duhet t'i përqafojë këto standarde pasi ato do të bëhen normat e vetë vendit në të ardhmen.
 4. Plani i Rritjes dhe Integritimit: Disa nisma janë ndërmarrë për të mbështetur integritimin e Shqipërisë në BE, duke përfshirë:
 - *SEPA (Single Euro Payments Area)*: Kjo do të rrisë konkurrencën e Shqipërisë duke thjeshtuar pagesat ndërkufitare.
 - *Pagesat dixhitale dhe roaming*: Përmirësime në sistemet e pagesave dixhitale dhe roaming të përballueshme për turistët dhe shqiptarët që udhetojnë drejt BE-së.
 - *Kalimet Kufitare*: Masa janë marrë për t'i bërë kalimet kufitare më efikase për mallrat dhe njerëzit.
 5. Mbështetje dhe financim: BE-ja do t'i japë Shqipërisë 900 milionë euro për të mbështetur reformat dhe përgatitjen për anëtarësimin në BE. Shqipëria duhet t'i përdorë këto fonde në mënyrë efikase dhe t'i japë prioritet reformave për t'u përshtatur me standardet e BE-së.

Ai përfundoi duke shprehur angazhim për të mbështetur përpjekjet dhe reformat integruese të Shqipërisë.

Ministri Blendi Gonxhja, MEKI, diskutoi mbi problemet që lidhen me bujqësinë dhe fondet e Bashkimit Evropian. Ai theksoi nevojën për të rishikuar pozitat e ndëshkimeve kolektive dhe për të siguruar vazhdimësinë e programeve zhvillimore. Ai vuri në dukje se Shqipëria duhet të konkurojë me fqinjët dhe rajonin që po përdorin fonde për zhvillim dhe se ndihma e BE-së është thelbësore për përparimin e vendit.

Ministri Gonxhja gjithashtu përmendi presionin e madh për borxhin dhe nevojën për të ulur borxhin në mënyrë të arsyeshme. Ai theksoi rëndësinë e fondeve evropiane për të arritur eficientë dhe për të përmirësuar situatën, duke vënë në dukje se këto fonde janë thelbësore për zhvillimin e vendit dhe kërkoi më shumë ndihmë dhe mirëkuptim nga BE për të përmbushur kërkesat dhe për të avancuar në procesin e integritimit evropian.

Z. Denald Tafani, Dhoma e Biznesit Grek në Shqipëri, theksoi rëndësinë e Këshillit dhe vlerën e diskutimeve midis bizneseve dhe qeverisë. Më tej, ai u shpreh se, ndërsa problemi i taksave është i vazhdueshëm, çështja më e madhe është aksesimi në financim dhe investime në inovacione dhe teknologji. Z. Tafani vuri në dukje se bizneset shqiptare prodhuese nuk janë në gjendje të konkurrojnë me ato që operojnë në Bashkimin Evropian, si italiane, greke, etj për shkak të mungesës së subvencioneve dhe financimeve të buta. Ai nënvizoi se, për shembull, një biznes grek apo italian mund të ketë 70% subvencione nga fonde të BE dhe 20% financim të butë, ndërsa një biznes shqiptar përballon të gjithë financimin me norma interesi të larta, 100% financim, me euribor, plus 2% ose 3%.

Gjithashtu, ai theksoi se shumë të rinj shqiptarë, punojnë në distancë për kompani të huaja. Ai e lidhi këtë fenomen me arsimin e kualifikuar që ata kanë marrë dhe theksoi nevojën që Shqipëria ka të përmirësojë edukimin dhe shërbimet për të mbështetur këta profesionistë dhe për të tërhequr më shumë kompani të huaja.

Znj. Bianca Duro, Pendl & Piswanger, si një sipërmarrëse me përvojë 25-vjeçare në edukim dhe 13 vite në certifikimin e personelit, diskutoi rëndësinë e zhvillimit të burimeve njerëzore në

Shqipëri. Ajo theksoi se problemi kryesor është ndihma në kualifikimin dhe certifikimin e personelit, dhe kërkoi një plan të qartë dhe të shpejtë nga qeveria shqiptare për të përmirësuar këtë situatë. Znj. Duro përmendi se ajo përfaqëson një trup certifikimi të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe ka kërkuar zgjerimin e fushës së akreditimit në sektorin e metalit, një sektor shumë i rregulluar në Evropë. Ajo vuri në dukje se sipërmarrësit shqiptarë shpesh përdorin specialistë nga jashtë për shkak të mungesës së burimeve të kualifikuara në Shqipëri.

Ajo kërkoi një ndërhyrje urgjente për të edukuar tregun dhe për të forcuar përgjegjësinë ndaj palëve të treta, duke theksuar se certifikatat e blera nuk kontribuojnë në ndihmën e biznesve. Znj. Duro gjithashtu kritikoi sistemin aktual të edukimit dhe certifikimit, duke përmendur se disa certifikata, si ajo për menaxherin e energjisë, nuk njihen nga shteti, edhe pse janë financuar nga fondet europiane.

Ajo përfundoi duke shprehur gatishmërinë për të kontribuar me përvojën e saj për të përmirësuar këtë situatë dhe për të ndihmuar në zhvillimin e burimeve njerëzore në Shqipëri.

Ministri Blendi Gonxhja, MEKI, u shpreh mbi përparimet dhe investimet në arsimin profesional në Shqipëri. Ai theksoi krijimin e dhjetë institucioneve të reja dhe modernizimin e strukturave të arsimit profesional përmes donatorëve dhe programeve ndërkombëtare. Ministri Gonxhja theksoi rëndësinë e investimeve në kualifikimin e të rinjve, veçanërisht për ata që janë në kushte ekonomike të vështira dhe që mund të kenë potencial të fshehur. Ai nënvizoi nevojën për të identifikuar dhe zhvilluar potencialet e brezit të ri, si dhe për të përmirësuar planifikimin ekonomik dhe urban për të adresuar problemet dhe për të rritur cilësinë e arsimit. Ai pranoi përgjegjësitë për ndonjë mosfunksionim dhe theksoi se Shqipëria mund të krenohet me përparimet në këtë fushë, sipas grafikëve të OECD-së, që tregojnë përmirësim cilësor në lidhje me politikat e kapitalit njerëzor dhe krahut të punës.

Znj. Bianca Duro, Pendl & Piswanger, shprehu vlerësim për investimet qeveritare në këtë drejtim. Gjithashtu, ajo theksoi rëndësinë e standardizimit dhe certifikimit të kompetencave për punë dhe aktivitete, duke i lidhur këto me standardet e Bashkimi Evropian. Ajo theksoi se disa standarde janë të detyrueshme dhe nuk janë vetëm vullnetare.

Ministri Blendi Gonxhja, MEKI, theksoi rëndësinë e kualifikimit të punëtorëve dhe nxiti rininë të ndjekë arsimin profesional në vend të profesioneve tradicionale si mjekët apo juristët. Ai kritikoi sistemin e kaluar, ku diplomatë dhe certifikata mund të ishin të blera, dhe theksoi nevojën për krijimin e mundësive për trajnim në profesione të mirëfillta dhe të mirëpaguara.

IV. Përditësim mbi statusin e Rekomandimeve të KI, Janar-Qershor 2024

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, dha një prezantim të shkurtër mbi statusin e rekomandimeve të mëparshme të Këshillit të Investimeve, duke theksuar se nga 334 rekomandime të dhëna në vitin 2015, 48% janë zbatuar, ndërsa 113 mbeten të pazbatuara. Të dhënat përditësohen nga Sekretariati në bazë të përgjigjeve zyrtare dhe informacionit publik në burime zyrtare. Në gjysmën e parë të 2024, janë zbatuar 17 rekomandime në sektorët e turizmit, bujqësisë dhe agropërpunimit. Një problem kryesor ka qenë mundësimi i sistemit të pagesave online për shërbime administrative, por tani ekziston një marrëveshje për pagesat online për disa shërbime përmes një banke të caktuar. Pagesat online kanë qenë një sfidë për qeverinë, e cila ka ndërmjetësuar me shoqatën e bankave për të zgjidhur këtë çështje.

Znj. Irida Huta, Shoqata e Bankave, informoi mbi disa zhvillime në lidhje me ofrimin e shërbimeve të pagesave online për shërbimet qeveritare përmes bankave. Ofrimi i shërbimeve të pagesave

përmes bankave ka qenë një sfidë dhe është një nga objektivat kryesore të punës aktuale. Procesi për zbatimin e këtij rekomandimi është përfunduar. Aktualisht, një bankë ka qenë në treg për më shumë se tre muaj duke ofruar këtë shërbim, dhe tre banka të tjera kanë filluar ofrimin e shërbimeve të ngjashme. Shërbimet kryesore janë të përfunduara dhe po vazhdojnë të zgjerohen. Procesi është konsideruar i suksesshëm dhe ka marrë pranimin e tregut, duke u mirëpritur nga individët dhe bizneset.

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, paraqiti më tej disa zhvillime të tjera në zbatimin e rekomandimeve të KI në sektorë të ndryshëm. Ajo raportoi se ka pasur një integrim të suksesshëm të pushtetit lokal në procesin e pagesave online për shërbimet administrative, çka përfaqëson një hap përpara në përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës në nivel lokal. Gjithashtu, përmirësimi i sigurisë në platformat digjitale, përfshirë përgatitjen e dokumenteve dhe reformat e nevojshme, është në vazhdim, duke synuar rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë për përdoruesit. Në sektorin e turizmit, janë ndërmarrë hapa për të standardizuar kategoritë e subjekteve turistike dhe për të përmirësuar të dhënat statistikore, të cilat janë të rëndësishme për planifikimin dhe promovimin e sektorit. Në bujqësi, digitalizimi i regjistrit të tokës dhe përditësimi i informacionit për tokat bujqësore janë elementë kyç për rritjen e transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin e tokës. Për më tepër, janë ofruar mbështetje për grupet e fermerëve dhe janë përmirësuar regjistrimi dhe metodologjia për grumbullimin e të dhënave në sektorin e agropërpunimit, duke përfshirë edhe harmonizimin e certifikatave fitosanitare shqiptare me modelet ndërkombëtare.

Në fund, znj. Leka sugjeroi që raportime të tilla të bëhen një herë në vit në vend të çdo gjashtë muaj, për të pasur më shumë kohë për të marrë përgjigje zyrtare nga institucionet.

Ministri Blendi Gonxhja, MEKI, falenderoi mbi përditësimin dhe shprehu nevojën që Sekretariati të raportojë dhe ato ministri apo institucione që nuk kanë kthyer përgjigje.

V. Mbi Temën e Ardhshme për Diskutim

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, informoi anëtarët se tema e ardhshme për diskutim do të jetë aksesin në financë dhe detajet përkatëse do të shpërndahen në vijim.

Mbyllja e mbledhjes

Në përfundimin të të gjitha komenteve, Ministri Gonxhja falenderoi të gjithë të pranishmit dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Lista e pjesëmarrjes

Përfaqësues të qeverisë

1. Z. Blendi Gonxhja, Kryetar i Këshillit të Investimeve/Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
2. Përfaqësues deleguar nga znj. Laura Plaku, CEO, AIDA

Përfaqësues të biznesit

1. Znj. Albana Laknori, Sekretare e Përgjithshme, deleguar nga z. Nikolin Jaka, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
2. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
3. Z. Ardian Lekaj, Kryetar, Dhoma Shqiptare e Biznesit të Diasporës
4. Z. Balazs Revesz, President, Shoqata e Investitorëve të Huaj (FIAA)
5. Znj. Antonela Hako, Kryetare, Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)
6. Znj. Bilgen Aldan, Kryetare, ICC Albania
7. Z. Grant Van Cleve, President, AmCham Albania
8. Znj. Irida Huta, Menaxhere e Dept. Kanaleve Digjitale, OTP, deleguar nga z. Bledar Shella, Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, Shoqata Shqiptare e Bankave
9. Z. Denald George Tafani, Kryetar, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
10. Z. Valer Pinderi, Kryetar, Shoqata e Tregtisë Elektronike (AECA)
11. Pendl & Piswanger (*ad-hoc*)
12. Emante Panel (*ad-hoc*)

Partnerë ndërkombëtarë

1. Z. Hubert Perr, Shef i Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së
2. Znj. Ekaterina Solovova, Drejtore e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
3. Z. Emanuel Salinas, Menaxher i Bankës Botërore
4. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese, IFC

Nuk morën pjesë:

1. Znj. Delina Ibrahimaj, Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
2. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
3. Z. Sergio Fontana, President, Confindustria Albania

Të ftuar të veçantë:

1. Z. Endrit Yzeiraj, Zv/Ministër i Financave dhe Ekonomisë
2. Z. Philip Arnold, Zëvendës Shefi i Misionit në Ambasadën e Zvicrës

Të ftuar të tjerë:

3. Znj. Anxhela Bushati, Drejtore, MEKI
4. Znj. Vjollca Bazaiti, Pergjegjes i Sektorit të Monitorimit të Standardeve dhe Rregullave Ndertimore, MIE
5. Znj. Ardita Mele, Drejtore Dept. Akreditimit, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
6. Z. Riza Hasanaj, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
7. Z. Petrit Rama, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

8. Znj. Erinda Piluri, Zv. Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
9. Z. Aleko Polo, CEO, Shoqata e Prodhuesve
10. Znj. Brunilda Isaj, Sekretare e Përgjithshme, Shoqata e Mikrofinancës (AMA)
11. Z. Edvin Prençe, Kryetar, Pro-Eksport, Albania
12. Z. Neritan Mullaj, CEO, AmCham
13. Znj. Ardita Seknaj, Sekretare e Përgjithshme, ICC Albania
14. Znj. Anila Jani, Eksperte
15. Z. Gledis Shehu, Ekspert
16. Znj. Erifili Berberi, Drejtore Ekzekutive, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
17. Z. Reinaldo Pipiria, Kryetar, Shoqata e Pasurive të Patundshme
18. Znj. Tiziana Domi, Koordinatore Projekti, SWISSA
19. Znj. Erjola Vejzati, BMP
20. Z. Arben Memo, Ekspert
21. Z. Ardian Hackaj, Drejtor i Kërkimit, CDI Institute
22. Znj. Borana Kalemi, Project Associate, Swiss Contact
23. Znj. Blerina Raca, Menaxhere Projekti, GIZ
24. Znj. Eranda Begaj, Country Coordinator, GIZ
25. Z. Erald Buzi, Këshilltar, ProSEED, GIZ
26. Znj. Esmeralda Ballesha, Përfaqësuese, CIPE
27. Znj. Aida Lahi, Këshilltare për Politika, Ambasada Hollandeze
28. Z. Keler Gjika, Specialist i Lartë i Sektorit Financiar, Banka Botërore
29. Znj. Sigita Stafa, Manaxhere Programi, Ambasada e Zvicrës në Shqipëri
30. Znj. Endrita Xhaferaj, Këshilltare e Lartë, BERZH